



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0061**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE “Pro & Co Group SH.P.K.” kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit” me nr. të prokurimit: "651-23-13546-5-1-1" iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjilanit, më 29/02/2024 mori këtë:

## **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Pro & Co Group Sh.P.K.” me nr. 2024/0061, e datës, 20/01/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit” me nr. të prokurimit: "651-23-13546-5-1-1" iniciuar nga autoriteti kontraktues(AK), Komuna e Gjilanit.
2. Obligohet AK/Komuna Gjilan, që lidhur me aktivitetin e prokurimit; 651-23-13546-5-1-1, të përmirësojë Dosjen Tenderit/ Njoftim për Kontratë B05, sipas konstatimit të dhënë nga Paneli Shqyrtues, në arsyetim të vendimit dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas ligjit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarrura lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.
4. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës OE ankues, sipas nenit 31.4 dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 07/12/2023, Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 15,000,000.00 €.

Me 09/01/2024, OE “Pro & Co Group SH.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 12/01/2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 20/01/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Pro & Co Group SH.P.K.” me nr. 61/23 lidhur me aktivitetin “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit” me nr. të prokurimit: "651-23-13546-5-1-1".

Me 20.02.2024, me fillim në ora 14,00,min, në OSHP, është mbajtur seanca dëgjimore, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve; Autoriteti Kontraktues/Komuna Gjilan, Operatori Ekonomik ankues Pro & Co Group Sh.P.K dhe monitorues të shoqërisë civile GLPS.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Pro & Co Group SH.P.K.” janë parashtruar si në vijim:*

Sqarim Hyrës: “Bazuar në dispozitat e nenit 109 të LPP-së dhe në afatin ligjor paraqesim ankesë kundër AK Komuna Gjilanit, lidhur me kriteret e vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë sa i përket procedurës së prokurimit: “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit”, me nr. Prokurimi: 651-23-13546-5-1-1, lidhur me kriteret e vendosura në FDT dhe Njoftimin për kontratë si të kundërligjshme përfshirë edhe ato të ndryshuara dhe plotësuara me njoftimin përmirësimin e gabimit të datës 29.12.2023. Autoriteti Kontraktues Komuna Gjilanit me rastin e nxjerrjes së vendimit në lidhje me kërkesën tonë për rishqyrtim e vendimit të AK-së të datës 12.01.2024, ka bërë shkelje të rëndë të nenit 108/A, paragraf 6 dhe 9 i LPP-së sepse nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të cilat i kemi parashtruar, por vetëm ka nxjerrur vendim duke refuzuar ankesën pa dhënë asnjë përgjigje në pretendimet ankimore siç është e obliguar për të dhënë përgjigje për secilin pretendim ankimore. Në vendimin e nxjerrë nga AK Komuna Gjilan, lidhur me ankesën tonë është përgjigjur duke u thirrur në nenin 66, par. 1 dhe 2, duke arsyetuar se lënda gjendet në OSHP sepse OE Bardhi Ndërtim SHPK ka parashtruar ankesë OSHP lidhur me kriteret. Pas analizimit të vendimit lidhur me pretendimet ankimore të parashtruar në ankesën OE Bardhi Ndërtim SHPK, i cila ka parashtruar ankesë në OSHP, kemi konstatuar se pretendimet ankimore të këtij OE ankues nuk kanë të bëjnë fare me pretendimet ankimore për të cilat ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Po ashtu ju sqarojmë se edhe sikur të ishin pretendimet e njëjta ankimore AK Komuna Gjilanit është e obliguar në bazë të LPP-së neni 108/A të ju përgjigjet secilit OE me vendim në lidhje me të gjitha pretendimet ankimore që parashtron, por në rastin konkret AK Komuna Gjilanit ka tentuar të na lajthit në si OE duke mos kthyer përgjigje në pretendimet tonë ankimore, duke qenë në dijeni se ka vendosur kritere diskriminuese dhe duke tentuar për të anashkaluar pretendimet tonë ankimore.”

Pretendimi i parë (I): “OE ankues pretendon se me rastin e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim, AK-ja nuk ka kthyer përgjigje në asnjë prej pretendimeve ankimore me arsyetimin se për të njëjtin aktivitet të prokurimit ka parashtruar ankesë në OSHP, një operatore ekonomik.”

Pretendimi i dytë (II): “OE ankues pretendon se AK-ja, në kërkesën nr. 2 pika B, ka kërkuar: Një udhëheqës i punishtës Inxhinier i diplomuar ose mastër i Arkitekturës, i certifikuar me FIDIC dhe i certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa sipas standardit DIN EN 16247, me minimum 5 (pesë) vite

përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjashme-ndërtim i lartë ose ndërtim i ulët. OE ankues e kundërshton kërkesën e cituar me lartë, me arsyetimin se ka kërkuar nga vetëm një person qe te ketë kualifikimet e përmendura ne kërkesë.”

Pretendimi i tretë (III): “OE ankues pretendon se AK-ja, ne kërkesën nr. 2 pika H, ku ka kërkuar: OE duhet të ofroj dëshmi se posedon iso standardë ISO DS CEN/TR 15128 2005 një person për drenazhim të dheut, ndërsa si dëshmi dokumentare ka kërkuar: OE duhet të ofroj dëshmi certifikatën e ISO standardit kopje te noterizuara nga origjinali për drenazhim të dheut. Sipas OE ankues me ketë kërkesë AK-ja ka krijuar dykuptimësi me vet faktin se te kërkesa kërkon një person me ISO standardin e cekur me lart, ndërsa te dëshmia dokumentare ka kërkuar nga operatori ekonomik te dorëzoje ISO standardin.”

Pretendimi i katërt (IV):” Ngjashëm sikurse te pretendimi nr. 3 OE ankues pretendon se AK-ja, ka vepruar ne kundërshtim me nenin 7 te LPP-se, me vet faktin se ne kërkesën nr. 3, ka kërkuar: OE të ketë një Lead Auditor sipas kërkesës së standardit ISO 9001, dhe i njëjti duhet të jetë i Certifikuar edhe për Siguri dhe Shëndet në punë, si dhe të jetë i trajnuar për ekspert i mjedisit, ndërsa si dëshmi dokumentare ka kërkuar: Kontrata ose para kontrata e punës, Diplomat ose certifikatat. Cv.”

Pretendimi i pestë (V): “OE ankues pretendon se kërkesa e AK-se, e vendosur ne dosje te tenderit, ne piken, 2, pika ë, është kërkuar: Një inxhinier i diplomuar ne menaxhimin e emergjencave ose bachelor ne menaxhimin e emergjencave me jo më pak se 1 vite përvojë pune në profesion, te ketë te kryer trajnimin për siguri dhe shëndet ne pune nga një kompani e licencuar nga MPMS. Me këtë rast OE ankues pretendon se ka len mangësi te pjesa e dëshmisë dokumentare sepse sipas OE ankues, AK-ja, ne dosje te tenderit nuk ka kërkuar kurrfarë dëshmi lidhur me trajnimin për siguri dhe shëndet ne pune.”

Pretendimi i gjashtë (VI): “OE ankues, pretendon se AK-ja, ne dosje te tenderit ne lidhje me pajisjet për realizimin e projektit ka kërkuar: Lugë ngarkuese 2 - 3 t, Lugë ngarkuese 5 - 6t, Eskavator minimum 5 - 10 ton, Kamion vetëshkarkues me kran peshe bartëse 2-3 ton, Autofshise speciale për pastrim pas përfundimit te punëve me peshe deri ne 1- 3 Ton, Cylinder, minimum 2.5-3t, Damper 1-3 ton, Eskavator me lugë ngarkuese para dhe mbrapa, Traktor me piing dhe pijator deri 2 tone, traktor me frez deri 2 tone, Makinë për ngivrosje, Kamion për heqjen e ujerave fekale, zhbllokimin e kamalizimir vin. 13.000.00kg. Për pajisjet e cekura me lartë, OE ankues pretendon se me vet faktin qe AK-ja ka përcaktuar një minimum dhe maksimum, kufizohet pjesëmarrja e OE-ve ne një aktivitet te prokurimit.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Pro & Co Group SH.P.K.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkëlur nenin Neni 7, 24, 27, 51, 52, 57, dhe 60 të LPP-së si dhe neni 97 i Rregullores PP, nr.001/2022. Kërkojmë nga OSHP që të merr Vendim që të aprovoj ne tërësi ankesën tonë si të bazuar, të anuloi në tërësi këtë procedurë të prokurimit si të kundërligjshme, të Ri tenderohet ky proces, duke u bazuar ne dispozita ligjore dhe te aplikohen kërkesa relevante dhe proporcionale ne raport me aktivitetin e prokurimit siç përcaktohet me nenin 7, 27, 28, 52.3, të LPP-së.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 25/01/2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 61/24, ndërsa me datë 05/02/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 24/61 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa njoftimi për kontrate të anulohet në mënyrë që AK-ja të bëjë përmirësimet e nevojshme ne harmoni me nenin 53 të LPP-së.

*Vlerësimi i ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 0061/2024, të pretendimeve ankimore të OE ankues, si në vijim;*

Sqarim hyrës: Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, ka publikuar dosjen e tenderit lidhur me ketë aktivitet të prokurimit, dhe pasi qe OE ankues e ka tërhequr ka vërejtur dhe njëherit pretendon se AK-ja, ka

vendosur kritere diskriminuese dhe favorizuese. Prandaj ne ankesën e tij kërkon qe disa kërkesa te ndryshohen /plotësohen.

Konstatimi i parë (I): “Eksperti shqyrtues, sqaron se qëndron pretendimi i OE ankues për mosrespektim te dispozitave te nenit 108/A, për faktin se AK-ja nuk i është përgjigjur ne pretendimet ankimore të parashtruara nga OE ankues.”

Konstatimi i dytë (II): “Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja nuk ka dhënë një sqarim lidhur me këtë çështje se pse janë kërkuar te gjitha këto certifikata kur kemi te bëjmë me renovim, e në veçanti pse është i nevojshëm certifikimi nga organizata FIDIC, ne te cilën sipas web faqes se fidic, org rezulton se kjo organizatë lëshon disa certifikata ne disa fusha te biznesit dhe autoriteti kontaktues nuk e ka specifikuar se çfarë certifikimi duhet te ketë udhëheqësi i punishtes. Ne vlerësim te ekspertit kërkesa për certifikim nga organizata Fidic duhet te hiqet nga kërkesa e dosjes se tenderit.”

Konstatimi i tretë (III): “Eksperti shqyrtues vlerëson se kjo kërkesë duhet te specifikohet qartë, për faktin se qëndron pretendimi i OE ankuese për dykuptimësi te kësaj kërkesë”.

Konstatimi i katërt (IV): “Eksperti shqyrtues fillimisht sa i përket kësaj kërkesë sqaron se dëshmia dokumentare ku AK-ja, ka kërkuar Diplomat ose certifikatat. CV, është ne kundërshtim me kërkesën dhe njëherit nuk mund te konsiderohet si dokument ekuivalent Diploma ose certifikatat. Prandaj kjo kërkesë duhet te formulohet ne mënyrë qe te mos ketë paqartësi dhe dëshmia dokumentare te jetë ne harmoni me kërkesën e dosjes se tenderit.”

Konstatimi i pestë (V): “Ky pretendim i OE ankues qëndron, sepse pas ekzaminimit te dosjes se tenderit eksperti shqyrtues nuk ka vërejtur se AK-ja ka kërkuar ndonjë dëshmi lidhur me ketë kërkesë.”

Konstatimi i gjashtë (VI): “Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues, sepse përcaktimi i minimum dhe maksimumi te peshës se një pajisje do te thotë qe OE-te kanë hapësirë më të madhe të përzgjedhjes. Në fund, eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-ja duhet te beje korrigjimet e përmendura me lart dhe ne veçanti ti formuloje saktë kërkesat e dosjes së tenderit të cilat njëherit duhet të jen ne harmoni të plot me dëshminë dokumentare dhe poashtu sa te jetë e mundur AK-ja ti ndaj ne disa kërkesa siç është rasti i kërkesës nr. 2, pikës B, ku AK-ja ka kërkuar katër kualifikime për një inxhinier. Po ashtu i rekomandoj AK-se, që në rast se pranon kërkesë për rishqyrtim të përgjigjet në përputhje të plot me paragrafin 9 të nenit 108/A, i cili e obligon AK-në që refuzimin e ankesës/prendimeve ta arsyetoj me shkrim.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Pro & Co Group SH.P.K.” Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Pro & Co Group SH.P.K.” janë të bazuara.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE pajtohet pjesërisht rreth rekomandimeve te ekspertit shqyrtues.

*Seanca dëgjimore në OSHP, me 20.02.2024, me palët ;Autoriteti Kontraktues/Komuna Gjilan dhe Operatori Ekonomik ankues Pro & Co Group Sh.P.K .*

Paneli shqyrtues duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, neni 107 pika ;(iv) që përcakton” të drejtën e palëve për të dorëzuar dëshmitë dhe argumentet në dëgjimin para OSHP-së, përfshirë provat dhe

marrjen e dëshmitarëve në pyetje”, si dhe nenin 116 Procedurat e vendim-marrjes, paragrafi 1., të po ketij ligji që përcakton, ”Para marrjes së një vendimi përfundimtar mbi një çështje, OSHP mund të kërkojë nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë” dhe të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së n:83/20, Paneli më datën 20.02.2024, ka mbajtur seance dëgjimore me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore, lidhur me objektin e ankesës, me pjesëmarrje të përfaqësuesve nga; Autoritetit kontraktues/Komuna Gjilan, Operatori Ekonomik ankues Pro & Co Group Sh.P.K, Eksperti shqyrtues dhe monitorues të shoqërisë civile, GLPS.

Paneli shqyrtues në seance dëgjimore fillimisht ka kërkuar nga përfaqësuesi i OE ankues që para panelit të arsyetojnë pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë.

*Operatori Ekonomik ankues Pro & Co Group Sh.P.K ka deklaruar si në vijim:*

” Në lidhje me këtë AP ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK fillimisht dhe pas refuzimit të kërkesës sonë për rishqyrtim në afatin ligjor në bazë të nenit 109 të LPP kemi parashtruar ankesë në OSHP për të cilën jemi këtu.

Ne kemi pranuar raportin e ekspertës dhe jemi pajtuar pjesërisht me raportin e ekspertës vetëm sa i përket pretendimit ankimor në lidhje me makinerinë nuk jemi pajtuar me konstatimin e formuluar nga ekspertja sepse lista e makinerisë dhe pajisjeve e kërkuar në FDT e njëjta përben kufizim si dhe favorizim të ndonjë OE të caktuar për faktin se AK KK Gjilan është lëshuar duke kërkuar pjesë përbërëse të makinerisë dhe jo makineri .

Siç është luga ngarkuese 5 -6 T kur ne i kemi të bëjmë me ekzekutimi e punimeve dhe jo furnizimin e makinerisë për faktin se luga ngarkues është epjes përbërëse së makinerisë dhe përdoret sipas nevojës në vend punishte por e rëndësishme është me u kërkuar makineria e cila do ta ekzekutoj .

Po ashtu kufizimi 5-6 T është diskriminues sepse AK i ndalohet të kërkojë specifikim minimum dhe maksimum dhe jo të kufizoj specifikimin në atë formë që të përshtatet ndonjë OE të caktuar .

Pasi që është një listë e gjatë e makinerisë dhe i kemi specifikuar në ankesën tonë i kërkojë panelit shqyrtues që të vlerësojë këto pretendime ankimore tonat për secilën pajisje e të cilën e kemi përshkruar në ankesë sepse jemi të bindur që janë të formuluar në atë formë që diskriminojnë pjesëmarrjen në këtë AP.

Po ashtu na kemi disa vendime të OSHP për qeshtje të njëjta sa për të rikujtuar PSH kemi vendimin e fundit me nr.2023/0845.

Po ashtu në lidhje edhe me kriteret tjera që i kemi përshkruar që ekspertja i ka aprovuar si të bazuara lidhur me inxhinieret e kërkuar lidhur me stafin profesional inxhinieret, ku janë kërkuar disa kualifikime të inxhinierit duke fokusuar kërkesën të vetëm një inxhinier dhe duke ja përshtatur këto kualifikime me qëllim të favorizimit. Siç është rasti me udhëheqësin e punishtës po ashtu kemi edhe një kërkesë të cilën AK qartazi nuk ka qenë në dijeni se çka ka kërkuar në kërkesë dhe cila është dëshmia dokumentare për rate krekës, sepse tek kërkesa kërkohet që OE të posedon ISO standard një person për dranzhim të dheut ndërsa të dëshmia dokumentare kërkohet që të ofroj OE ISO standard për dranzhim të dheut.

Po ashtu edhe në lidhje me udhëheqësin e punishtës inxhinierin e diplomuar ose master i arkitekturës, i certifikuar me fidec kjo certifikata është një standard ndërkombëtar që aplikohet tek kontratat fidic dhe në rastin tonë nuk kemi të bëjmë me kontratë fidic, sepse kontratat fidic janë multi komplekse ku përdoren në vende të veçanta dhe aplikohen variantet në ato kontrata ndërsa në rastin e AP për të cilën jemi këtu variantet nuk janë të autorizuar nga AK në dosjen e tenderit, dhe kemi të bëjmë me kontratë standarde sipas DT dhe ligjeve të APLIKUSHME NE Kosovë.

Po ashtu për të vazhduar në lidhje me këtë kërkesë udhëheqësi i punishtës janë kërkuar edhe 4 kualifikimet e tjera për të njetin inxhinier kur kemi një numër me të lartë të inxhinierëve kanë mundur të fokusohen tek inxhinieret në përgjithësi por jo të fokusohen vetëm në një inxhinier dhe të përshtaten atij

inxhinieri.

Ne i kërkojmë panelit që të aprovoj në përgjithësi pretendimet ankimore tonat si OE të obligoj AK të largoj kriteret diskriminuese të cilat i kemi paraqit në ankesën tonë dhe ne jherit mbesim në tersi pran ankesën sonë.

*Përfaqësuesi i AK, Komuna Gjilan, në seancën dëgjimore Panelit ja ka ofruar një shkresë me shkrim përmes të cilës ka kontestuar pretendimet ankimore të OE ankues si në vijim;*

” Fillimisht më lejoni që të theksoj se vlerësimet e kontatuara në raportin e ekspertit shqyrtues me numër 2024/0061 i datës 05.02.2023 lidhur me çështjet e parashtruara në ankesën e OE “Pro&Co Group” Sh.p.k. kundër kriterëve për kualifikim të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit” me numër të prokurimit 651-23-13546-5-1-1, nuk qëndrojnë sepse janë të pabazuara dhe të paargumentuara në asnjë provë dhe fakt. Kjo për faktin se, në konstatimet dhe mendimin e raportit të ekspertit shqyrtues mbi pretendimet e OE ankues janë dhënë vlerësime të supozuara pa u bazuar fakte dhe në ligj dhe që nuk i takojnë vlerësimin profesional dhe të pavarur ashtu sikurse këto përgjegjësi i adresohen ekspertit në kuptim të nenit 114 të LPP-së. Pasi me këtë ekspertizë të hartuar nga ekspertja shqyrtuese e prokurimit Florije Rexhepi është paraqitur vlerësim i gabuar i gjendjes faktike dhe juridike që nuk përkon me realitetin dhe që nuk është bazuar me dispozitat ligjore në LPP si ligj material i zbatueshëm pavarësisht faktit qenësor se, kriteret për kualifikim të kontestuara nga ana e OE ankues dhe të gjitha kushtet dhe termert e dosjes së tenderit janë vendosur duke u nisur në kontekst të relevancës dhe proporcionalitetit të kriterëve në relacion me natyrën, objektin, kompleksitetin dhe specifikat e projektit në nivelin e standardeve të pranueshme ndërkombëtare sipas udhëzuesve të UEFA-s për infrastrukturën dhe cilësinë e stadiumit, ashtu siç përcaktohet me parimet bazike të prokurimit dhe dispozitën e nenit 7 të LPP-së lidhur me dispozitat tjera relevante të prokurimit publik. Përveç kësaj, këto kriterë janë në funksion për të arritur qëllimin që procesi i renovimit/rikonfigurimit të stadiumit të përfundojë dhe realizohet me sukses, cilësi dhe në kohë optimale nga kompani të specializuara nga fusha e projekteve të tilla siç është vet stadiumi në bazë të standardeve të kërkuara për t’u kualifikuar si stadium i kategorisë së katërt (mbi tetë mijë ulëse) sipas udhëzimeve të UEFA-s dhe kriterëve tjera të nevojshme. Dhe në këtë mënyrë të sigurohen kushtet themelore që ky stadium të vihet në dispozicion të dy klubeve elitare të Super Ligës së Kosovës, KF Drita dhe KF Gjilani, pasi ato po detyrohen që ndeshjet t’i zhvillojnë në fusha me bari sintetik apo qytete tjera dhe në rastin më të keq në pamundësi të zhvillimit të tyre t’i humbin me rezultat zyrtar. Sepse siç e theksojnë gjetjet e auditimit të gushtit 2023 të Raportit të Performancës - Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë i Zyrës Kombëtare të Auditimit, për sa i përket renovimit të stadiumit të të Gjilanit që kishte filluar në tetorin e vitit 2017 deri në shtatorin e vitit 2020, ndër tjera është gjetur se: Punimet për renovimin e stadiumit të qytetit kishin vazhduar me një ritëm të ngadaltë dhe ndërprerje të shumta, fillimisht për shkak të gjendjes pandemike, pastaj për shkak të problemeve me cilësinë e projektit si dhe çështjeve pronësore...Mos ri-projektimi për renovimin e stadiumit të qytetit të Gjilanit kishte bërë që komuna të hasë në vështirësi dhe dinamikë të zvogëluar të punimeve si dhe shtyrje të afatit të realizimit të punimeve përmes amandamentimit kohorë për dy vite. Kjo kishte rezultuar me ndryshime të theksuara të disa pozicioneve si dhe ndërprerje të kontratës dhe rikthim në pikën zero të procesit.

Shikuar nga kjo perspektivë, AK – Komuna e Gjilanit me qëllim të funksionalizimit të këtij projekti jetik për klubet futbollistike në Gjilan, por jo vetëm, i ka ndërmarrë të gjitha masat dhe hapat konform të gjeturave dhe rekomandimeve të ZKA me rastin e ri-projektimit të renovimit të stadiumit (hartim të projektit ideorë dhe kryesorë) dhe në këtë mënyrë ka ndjekur procedurën e duhur të prokurimit përfshirë edhe vendosjen e kushteve/kriterëve kualifikuesë dhe vlerësuesë në përputhshmëri me objektin dhe specifikat e projektit dhe në pajtim me kriteret ligjore të LPP-së që nuk cenojnë transparencën dhe konkurrencën e lirë në procesin e prokurimit. Rrjedhimisht kriterë të drejta, relevante dhe proporcionale që nuk krijojnë favore apo disfatore në dëm apo dobi të njëres palë, por kriterë të lejuara që sigurojnë barazi në trajtim ashtu siç sanksionohet me parimet bazike të prokurimit dhe nenit 7 të LPP-së lidhur me

dispozitat tjera relevante të prokurimit publik. Prandaj, se në procesin e këtij aktiviteti nuk ka pasur asnjë kriter që krijon favore respektivisht disfavore në dëm apo dobi të njëjës apo tjetrës palë, dhe rrjedhimisht nuk ka bazë argumentuese që aktiviteti të anulohet siç është konstatuar në raportin e ekspertit shqyrtues, e kundërgargumentojmë me faktet dhe provat që do t'i radhisim në vijim: Kërkesa 2 pika b) që Udhëheqësi i punishtës, inxhinieri i diplomuar ose master i arkitekturës i çertifikuar me FIDIC dhe i çertifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa sipas standardit DIN EN 16247, është kërkesë drejtpëdrejtë relevante, proporcionale dhe e domosdoshme në relacion me natyrën, objektin, kompleksitetin dhe specifikat e projektit në nivelin e standardeve të pranueshme ndërkombëtare sipas udhëzuesve të UEFA-s për infrastrukturën dhe cilësinë e stadiumit. Dhe si e tillë nuk ka asnjë efekt kufizues apo favorizues në dëm apo dobi të njëjës apo tjetrës palë, por është në harmoni me parimet bazike të prokurimit dhe përcaktimet e dispozitës të nenit 7 të LPP-së lidhur me dispozitat tjera relevante të prokurimit publik. Për sa i përket kërkesës që Udhëheqësi i Punishtës të jetë i Çertifikuar me FIDIC, më lejoni të ju sqarojmë se: FIDIC (Certification Body for Global Consulting Professionals) është një Organizatë Çertifikuese për Profesionistët e Konsulencës Globale për të ofruar shërbime certifikimi dhe zhvillimi profesional për profesionistë të ndryshëm dhe ekspertë të industrisë së infrastrukturës që dëshirojnë të zgjerojnë fushën e njohurive dhe ekspertizës së tyre. Konkretisht FIDIC në kuadër të programeve dhe provimeve të çertifikimit bënë certifikimin e menaxherëve të kontratave FIDIC, që është një kualifikim i njohur ndërkombëtarisht dhe i domosdoshëm për të gjithë profesionistët që punojnë në menaxhimin e kontratave FIDIC të cilët dëshirojnë të vërtetojnë aftësitë e tyre për sa i përket analizës dhe menaxhimit dhe ofrimit të projekteve. Detyrat kryesore që lidhen me menaxhimin e kontratave FIDIC të ciklit jetësor të projektit janë të listuara më poshtë: faza e fillimit të projektit, faza e parandërtimit, faza e ekzekutimit të punimeve, kontrolli i cilësisë dhe sigurimi i cilësisë, kontrolli financiar, menaxhimi i kërkesave dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve si dhe mbyllja e projektit. Programi i provimit për menaxher të çertifikuar të kontratës – përfshinë programet e mëposhtme të FIDIC:

-FIDIC Kushtet e Kontratës për Ndërtim

-FIDIC Kushtet e Kontratës për Impiante & Dizajn-Ndërtim

-Kushtet e kontratës FIDIC për projektet EPC Turnkey

Kërkesat dhe parakushtet e aplikimit për çertifikatën FIDIC për menaxher të kontratës - Kushteve dhe kërkesës për aplikimin e çertifikimit për programin – çertifikatën menaxher të çertifikuar i kontratës FIDIC mund t'i nënshirohet (përfshirë edhe mundësinë përmes internetit) kushdo që është i interesuar të aplokojë në këtë program kundrejt një tarife të pagesës për t'u avancuar dhe specializuar në sektorin e ndërtimit dhe që ka një kualifikim ose diplomë të ndërtimit, etj dhe që ka përvojë profesionale (min 3 ose 5 vjet) të përgjegjësive si inxhinier në menaxhimin e aspekteve të ndërtimit apo industrisë së infrastrukturës. Informata më të detajuara i gjeni duke u referuar në linkun [www.fcl.fidic.org](http://www.fcl.fidic.org)

Duke qenë se vet objekti dhe natyra e këtij stadiumi është një projekt i natyrës specifike dhe komplekse që kërkon rregulla të veçanta të ndërtimit dhe standarde/kritere sipas udhëzimeve të UEFA-s, për ta realizuar këtë projekt në kohë optimale, me sukses dhe cilësi në nivelin e standardeve të pranueshme ndërkombëtare dhe në mënyrë që mos të përsëriten dështimet e kaluara siç i shpjegojmë më sipër, andaj është e domosdoshme të kërkojmë kritere me kualifikime specifike siç janë çertifikatat përkatëse nga FIDIC dhe çertifikata të standardit DIN EN 16247 që janë lehtësisht të arritshme për çdo OE të interesuar që zotëron staf me kualifikimet e nevojshme profesionale dhe përvojën e duhur që janë në funksion të realizimit të suksesshëm të kontratës. Gjithashtu, duhet të kihet parasysh fakti se, Udhëheqësi i Punishtës që i adresohen këto përgjegjësi sipas profesionit/edukimit universitar dhe dy kualifikime të specializuara (FIDIC dhe DIN EN 16247) është stafi kyq i cili menaxhon dhe organizon zhvillimin e punimeve duke përfshirë edhe sigurinë e punishtës në të gjitha dimensionet gjatë periudhës së ekzekutimit të projektit.

Lidhur me Kërkesën 2 pika h) “ISO DC CEN/TR 15128 2005 një person për drenazhim të dheut”, AK konstaton se nuk qëndron i bazuar vlerësimi i ekspertit shqyrtues sepse kjo kërkesë nuk ka asnjë lloj dykuptimësie siç konstaton eksperti sepse vet përshkrimi i numrit të kërkesës së ISO standardit e

përcakton dhe i referohet qartësisht dhe saktësisht llojit të standardit. Kërkesa në fjalë do të ishte e paqartë nëse nuk i referohet asnjë standardi por vetëm thuhet ISO STANDARDE, e që në rastin konkret është e kundërta sepse ju është referuar llojit me numër të standardit siç u theksua më lartë. Lidhur me Kërkesën nr. 3 OE të ketë një Lead Auditor sipas kërkesës së standartit ISO 9001, dhe i njëjti duhet të jetë i Certifikuar edhe për Siguri dhe Shëndet në punë. AK konstaton se nuk qëndron i bazuar vlerësimi i ekspertit shqyrtues se dëshmia dokumentare është në kundërshtim me kërkesën nr. 3 (Lead Auditor) sepse secili Lead Auditor i certifikuar me ISO 9001 shumë thjeshtë mund të certifikohet me certifikatë për siguri dhe shëndet në punë dhe në këtë kontekst pjesa më e madhe e tyre janë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. Për më tepër sipas Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë përcaktohet se, çdo punëdhënës është i detyruar të ngarkojë një ose më shumë të punësuar, për të kryer aktivitete nga siguria dhe shëndeti në punë, ashtu që punëdhënsi për personat e ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë duhet të sigurojë trajnime për certifikim për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë dhe mjete të nevojshme për punë. Kurse nga ana tjetër, qëndron pjesërisht i bazuar vlerësimi për sa i takon mungesës së përshkrimit të dëshmisë dokumentare lidhur me certifikimin e Lead Auditorit për siguri dhe shëndet në punë, andaj ju sqarojmë se në rastin konkret ka ndodhur një lëshim teknik i paqëllimshëm, ashtu që kërkesa në fjalë duhet të përmbushet me dëshminë dokumentare sipas formulimit në vijim: Certifikatë për dhënien e provimit profesional për Siguri dhe Shëndet në Punë e lëshuar nga organi kompetent, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tani e fuzionuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Lidhur me Kërkesën nr. 2 pika ë) Një inxhinier i diplomuar ne menaxhimin e emergjencave ose bachelor ne menaxhimin e emergjencave me jo më pak se 1 vite përvojë pune në profesion, te kete te kryer trajnimin per siguri dhe shendet ne pune nga nje kompani e licencuar nga MPMS, AK vlerëson se qëndron pjesërisht i bazuar vlerësimi i ekspertit shqyrtues për sa i takon mungesës së përshkrimit të dëshmisë dokumentare lidhur me dëshminë për trajnimin për siguri dhe shëndet në punë, për inxhinierin e menaxhimit të emergjencave sepse si pasojë e një lëshimi teknik të paqëllimshëm përshkrimi i dëshmisë është bërë vetëm te kërkesa por jo edhe te pjesa ku përshkruhen dëshmitë dokumentare për plotësimin e kërkesave të tilla. Andaj ju njoftojmë se ky lëshim i natyrës teknike do të korrigjohet me plotësimin e të dhënave të qarta se kjo kërkesë përmbushet me dëshminë dokumentare sipas formulimit në vijim: Certifikatë për përfundimin e trajnimit nga lëmia e sigurisë dhe shëndetit në punë të lëshuar nga subjektet e licencuara të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Siguri dhe Shëndet në Punë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tani e fuzionuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. AK , më datë 15.12.2023 ka pranuar rekomandim nga KRPP-ja, ku pas pranimit te këtij rekomandimi AK-ja menjëherë ka ndërmarr veprimet e nevojshme për korrigjim ashtu siç na është kërkuar /Me e dt.26.12.2023 kemi njoftuar KRPP-n për hapat te cilat i ka ndërmarr nga AK-ja dhe po ashtu me datën 01.01.2024 ne e prokurim kemi publikuar Njoftimin për Korrigjimin e Procedurës . Për me shume informata shihni ju lutem Opinion e KRPP-s Autoriteti Kontraktues -Komuna e Gjilani ,gjate hartimit te dosjes se tenderit ,respektivisht kriterete kualifikuese për këtë aktivitet te prokurimit ka pas parasysh edhe Raporti i Auditimit të Përfomancës nga Zyra Kombëtare e Auditorëve Gusht 2023, lidhur me Renovimin dhe Konfigurimin e Stadioneve ku ndër ta është për Stadionin e Gjilanit, ku në rekomandim ceken mangësitë dhe aprovimet që duhet pasur nga UEFA, duke e konsideruar si projekt specifik dhe me standarde evropiane është e domosdoshme që kriteret të jen në harmoni me natyrën e Projektit dhe për këtë arsye kriteret e vendosura ne këtë aktivitet janë me specifike ne krahasim me aktivitete e tjera .Për me shume informata ,ju lutem shihni raportin e Auditorit.

Andaj, duke u bazuar në administrimin e të gjitha provave dhe fakteve në dispozicion të kësaj lënde dhe duke pasur parasysh rrethanat e natyrës, specifikave dhe qëllimit të rastit konkret, i propozojmë panelit shqyrtues që sa i takon sipas gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik, të merr këtë vendim: Refuzojë si të pabazuar ankesën e OE ankues Pro&Co Group SH.P.K. dhe, Lejoj AK-në të vazhdon më tutje me procesin e aktivitetit të prokurimit sipas dosjes të tenderit .

*Ekspertja Shqyrtuese gjatë prezantimit në seance deklaroj si në vijim;*



Fillimisht po filloj me OE i cili ka reaguar me kriterin e makinerisë lug ngarkuese 5-6 T këtë përgjigje e kom jep edhe ne raportin e datës 05.02.2024 i cili nuk është kriter diskriminues për arsyeje se është caktu limit 5-6 T që dmth është caktu limit që secili që shpreh interesim për këtë AP që ti jep hapsirë ka leju hapësirën 5-6 T dhe për mu nuk është diskriminues

Sa i përket AK ne disa përdime janë pajtuar që kanë lëshime teknike ndërsa ne dy pretendimet fillimisht te kërkesa numër 2 pika b ku ka qen kërkesa udhëheqësi i punishtes inxhiner i diplomuar ose master i arkitekturës i certifikuar me fidic dhe iso standardin 16247.

Ne lidhje me këtë qeshtje AK nuk ka dhene një sqarime pse jen kërkuar te gjitha këtu Certifikata kur kemi te bëjmë me renovim e ne veçanti vepse është i nevojshëm certifikimi nga organizata Fidic . e ne veçanti gjat hulumtimit tim kjo organizata figuron që lëshon disa certifikatë nga fusha e biznesit dhe me këtë rast AK nuk ka specifikuar se qfar certifikatë duhet te këtë udhëheqësi i punishtes .

Sa i përket pretendimit tjetër te kërkesë numër 2 pika H ku AK ka kërkuar që OE duhet te ofroj dëshmi se posedon ISO standardet 15128/2005 një person për dranazhim te dheut dhe te kërkesa dokumentare ka kërkuar që OE duhet te ofrojnë dëshmi certifikatën e ISO standardit kopjen te noterizuar nga origjinali per dranazhim të dheut .

Me këtë rast gjatë vlerësimit kom konstatua që AK duhet te specifikoj qartë për faktin se kjo pik ka dy kuptimsi.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në seance dëgjimore të mbajtur me, 20.02.2024, me palët, Autoriteti kontraktues/Komuna Gjilan dhe Operatori ekonomik ankues Pro & Co Group Sh.P.K, pas shtjellimit te provave; Dosja e tenderit dhe Raporti i ekspertit shqyrtues dhe argumenteve të paraqitura nga palët në seance dëgjimore, ka ardhur te konstatimi, se në këtë aktivitet te prokurimit “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit” me nr. të prokurimit: "651-23-13546-5-1-1"autoriteti kontraktues(AK), Komuna e Gjilanit, kërkesat e Dosje se tenderit nuk janë hartuar në përputhje me LPP.

Paneli shqyrtues lidhur me kërkesën e Dosjes se tenderit te pika;" *III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 2. b)Një udhëheqës i punishtes Inxhinier i diplomuar ose mastër i Arkitekturës, i certifikuar me FIDIC dhe i certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa sipas standartit DIN EN 16247, me minimum 5 (pesë) vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjashme-ndërtim i lartë ose ndërtim i ulët",* PSH konstaton se kërkesa që Mbikëqyrësi- inxhinieri i punishtes të jete i certifikuar me dy standarde, paraqet kufizim të konkurrencës se lire në treg dhe mund të diskriminon OE potencial që mund të aplikojnë ne ketë aktivitet të prokurimit. Paneli shqyrtues kërkon që njëren certifikatë ta largojnë nga kërkesa dhe Autoriteti kontraktues mundet sipas vlerësimit të tije, atë mund ta kërkojnë tek cilido nga profesionet e kërkuara te kjo kërkesë, me shkronjat: a, c,d,e., ashtu që të mos humbet cilësia sipas standardit të kërkuar me certifikata, apo mund ta largojnë krejtësisht si kërkesë nga dosja e tenderit, sipas vlerësimit.

Po ashtu lidhur me këtë çështje Paneli shqyrtues, me datën 27.02.2024 përmes emailit zyrtar është njoftuar nga Komisioni Rregulativ i Prokurimit Publik, lidhur me gjetjet e monitorimit aktivitet të prokurimit "Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit" me nr. të prokurimit: "651-23-13546-5-1-1" dhe vërehet në shkresë e monitorimit ka paraqit vërejtjet e njëjta, me rekomandime përkatëse, tek kjo pike e Dosjes se tenderit.

Paneli shqyrtues rikujton se Autoritet kontraktues bazuar në dispozitat ligjore neni 108/A LPP duhet ti përgjigjen në Kërkesat për rishqyrtim për secilin pretendim ankimor të parashtruara nga OE, dhe vetëm pas vendimmarrjes nga AK, palët OE, mund ti drejtohen OSHP me parashtrëse nëse janë të pakënaqura me vendim.

Paneli shqyrtues vlerëson se Autoritetet kontraktuese ne bazë të nenit Neni 70 te LPP-se "Standardet për Sigurimin e Cilësisë" kane të drejte të kërkojnë nga OE plotësimin e një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë që bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare dhe të certifikuara nga organet që kryejnë veprimtaritë e tyre në pajtim me ato standarde për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të certifikimit, andaj dhe kërkesat e AK për të qene i certifikuar me FIDIC , certifikatë ndërkombëtare, është ne përputhje me ligjin por dhe me praktikat e disa aktiviteteve të prokurimit të mëparme të trajtuara nga OSHP.

Paneli shqyrtues vlerëson se Autoritetet kontraktuese në baze te nenit Neni 64 Dëshmitë e kërkesave, të LPP-se" kane të drejte të kërkojnë nga Operatorët ekonomik, apo një kandidat/tenderues, që për dëshmi të kërkesës; te ofrojnë certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme dhe kjo krijon hapësirë me mire dhe rrite konkurrencën e OE në aktivitetet e prokurimit.

Paneli shqyrtues konstaton se sa i përket pretendimeve tjera ankimore të Operatorit ekonomik ankues lidhur me kërkesat e Dosjes se tenderit janë të pabazuara pasi ai nuk ka arritur te dëshmojnë me argumente, se ato kufizojnë konkurrencën e lire ne treg dhe diskriminojnë atë në ketë aktivitet të prokurimit, por që me tepër kanë të bëjnë me mënyrën e përdorimit të terminologjisë dhe të formulimit të kërkesave në Dosjen e tenderit, e të cilat janë në diskrecion, dhe përgjegjësi ligjore të Autoritetit kontraktues në bazë të LPP.

Duke qenë se kërkesat e dosjes së tenderit nuk janë hartuar sipas nenit 28 të LPP-së dhe qëllimet e ligjit, Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që të bëjë zgjatjen e afatit për ofertim konform nenit 57.3 te LPP-së në mënyrë që ti bëjë përmisimet e nevojshme në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Paneli shqyrtues konstaton se përmirësimi i Dosjes se tenderit do të ofrohej mundësi më të madhe për pjesëmarrje të OE-ve ne aktivitetin e prokurimit, duke mos dëmtuar apo duke mos ulur cilësinë e produkteve/ushqimeve të kërkuara. PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet te jenë padrejtësisht te rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe

përgjyeshme të cilat nuk mund që të zbatohen kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim dhe në paqëndrueshmëri dhe kundërshtim me dispozitat ligjore.

Paneli shqyrtues konstaton se kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit pjesërisht të ankesës të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - Pro & Co Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: